Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti I i Botimit. **Nr. 2.** **Qershor 2006** Çmimi: **30** lekë

Prezantohet shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë"



FAQE 2

Botohen për herë të parë shënimet e ***Ismail Strazimirit***

Pushtimi i Dibrës prej ushtrisë Serbe

FAQE 6

Liman Hoxha*, dibrani që rihapi "Internatin" e Kastriotit në Tiranë*

Të mburremi për veprat që lëmë, jo për ata që na kanë lënë

FAQE 5

Katharsisi i odave dhe kuvendeve të Dibrës

Nga DUKAGJIN HATA

FAQE 7

Të huajt për Lurën

Nga AHMET PËRLEKA

FAQE 4

BIZNESI DIBRAN DHE "MIQTE E KORABIT"

Krijohet bordi në mbështeteje të sportit


FAQE 2

LETER E HAPUR

PUSHTETARË DHE OPOZITARË?

EDHE SA KOHË DO TË VAZHDONI TË MOS E MBANI PREMTIMIN E RRUGËS SË RE TË DIBRËS, "RRUGËS SË ARBËRIT"

Inxhinieri gjeolog, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, i shkruan Ministrit të Transporteve, z. Lulzim Basha



Studimi gjeologjik i aksit rrugor të "Rrugës së Arbërit"

FAQE 3

Faleminderit qytetit tim!

Mbresa nga një turne i topit të vogël të ping-pongut, që ndërtoi urën e madhe të miqësisë në qytetin tim të Peshkopisë

Nga **DEFRIM METHASANI**

FAQE 8

NJOFTIM

Njoftohen intelektualët dibranë, të cilët kanë dëshirë të anëtarësohen në shoqatën "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", se për t'u anëtarësuar duhet të plotësojnë "Formularin e anëtarësimit", të cilin mund ta gjejnë pranë redaksisë së gazetës, ose mund ta porosisin nëpërmjet postës elektronike.

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com.

Prezantohet shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë"



Në një nga sallat e Hotel Tirana International, më datë 27 maj 2006, ora 18, u mblodhën disa nga intelektualët dibranë që banojnë në Tiranë, ku dhe në prani të mediave të ndryshme, bënë prezantimin e shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Ky takim u organizua nga grupi nismëtar dhe pati si qëllim të diskutojë dhe të tërheqë vërejtjet nga një aktiv i gjërë i intelektualëve me përvojë në fushën e shkencës, të kulturës, administrimit publik dhe të biznesit. Fjalën përshëndetëse në emër të grupit nismëtar e mbajti Prof.Dr.Nuri Abdiu. "Dibranët, në përpjekje për të mbijetuar, në luftën heroike për ruajtjen e identitetit etnik dhe për të fituar mbi armiqtë e shumtë krijuan edhe kulturën e traditën e vet. Burrat e ditur të Dibrës, duke nisur nga përvoja dhe mendimi shkencor i vendit të tyre dhe i vendeve të tjera, kanë mbajtur gjithmonë një qëndrim aktiv. Ne dibranët kemi të drejtë të mburremi me të shkuarën dhe të ardhmen. Patriotizmi, burrnia, mençuria, besa dhe bujaria e dibranëve janë të spikatura. Figurat patriotike si Iljaz Pashë Dibra, Elez Isufi, Nikollë Kaçorri, Vehbi Dibra janë tashmë figura kombëtare, por ato në radhë të parë janë dibranë. Edhe ne, duke qenë të bashkuar, duke ecur në gjurmët e të parëve tanë jemi të bindur se do të bëjmë punë të mira par Dibrën dhe dibranët kudo qofshin ato", tha mes të tjerash Nuri Abdiu.



Hajri Mandri foli mbi zanafillën e shoqatës, mbi nismën e bukur që morën në fillim disa intelektualë për të ardhur deri këtu ku jemi. "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka si qëllim që të realizojë një bashkëpunim serioz, të organizuar dhe gjithpërfshirës të vlerave intelektuale, duke funksionuar brenda një formacioni të institucionalizuar me përgjegjsinë për të organizuar veprimtari që nxisin dhe promovojnë mendimin, vlerat dhe veprat e intelektualëve dibranë, në shfaqjet më të spikatura në fusha të ndryshme të jetës.Të kontriubojë në studimin, evidentimin, njohjen dhe përhapjen tek komuniteti dibranë dhe më gjërë të historisë së Dibrës, të zakoneve, traditave, të gjitha vlerave të mira dhe të bukura të arritura nga brezat e mëparshëm.

Zonja Edlira Haxhimeri foli në këtë takim mbi rolin e gruas dibrane. Shkrimtari Agron Tufa në diskutimin e tij u përqëndrua në atë se ne si shoqatë, duhet të konkurojmë me vlera. Dhe mes dibranëve ka mjaft vlera të pranueshme, tha ai.

Të pranishmit i përshëndeti dhe deputeti i zonës elektorale 22 zoti Sadri Abazi. "Jeni në udhë të mbarë. Uroj që në këtë udhë të mos ndaloni edhe pse mund të keni pengesa", nënvizoi Abazi.

Në fund u lexua dhe lista prej 21 vetash të anëtarëve të kryesisë, të cilët do të merren me organizimin e strukturave të shoqatës deri në zgjedhjet e ardhshme. Anëtarët e kryesisë janë: Nuri Abdiu, Musa Rriçku, Rakip Suli, Agron Tufa, Shaban Bitri, Hajri Mandri, Abaz Deda, Edlira Haxhiymeri, Hasan Çipuri, Hasan Leka, Agim Kukeli, Sali Shira, Shkëlqim Hoxha, Lavdrime Salku, Bashkim Lleshi, Bujar Karoshi, Shaqir Skarra, Ramazan Biba, Astrit Hoxha, Kamber Farruku, Huzri Hoxha.

Në fund, për të pranishmit u shtrua dhe një koktej si dhe u shpërnda edhe numri i parë i gazetës "Rruga e Arbërit".

Në mbledhjen e saj të parë, kryesia zgjodhi dy nënkryetar nga fusha e biznesit zotërinjtë Musa Rriçku dhe Rakip Suli, si dhe sekretarin organizativ zotin Shaqir Skarra. Mbledhja e radhës u caktua data 10 korrik.

BIZNESI DIBRAN DHE "MIQTE E KORABIT"

Krijohet bordi në mbështeteje të sportit

Hotel "Tirana Internacional" ka përjetuar shume veprimtari në ambjentet e saj, por ajo çfarë realizoi biznesi dibran, klubi Korabi, bashkia e qytetit, shoqata sportive "Forca Korabi" dhe SNV, sollën një risi në këtë fushë. Nisma e muajve më parë është kthyer në realitet, duke ftuar në një tryeze biznesmenet me drejtuesit e sportit në Peshkopi, drejtuesit e federatave sportive, komitetit olimpik si dhe ministrisë së TKRS. Drejtuesi i klubit Korabi, Telman Përleka, bëri një paraqitje të situatës reale ku ndodhet sporti dibran, duke treguar vështirësitë me të cilat ndeshen ekipet si: futbolli, volejbolli, mundja, etj, në infrastrukturë, bazë materiale dhe problemet finaciare. Ndërkaq, drejtuesi i shoqatës sportive "Forca Korabi", Agron Damzi, tregoi punën që ka bërë kjo shoqatë në ndihmë të sportit, jo vetëm moralisht, por edhe duke qënë mbështetëse e organizatore e disa kupave për moshat apo turnetë e minifutbollit. Me pas drejtori i sporteve në ministri, Mehmet Spahiu, tregoi gatishmërinë për ta ndihmuar sportin dibran me projekte konkrete në zhvillimin e tij dhe daljen nga situata ku ndodhet. Te gatshem kanë qënë edhe drejtuesit e federatave të volejbollit, mundjes, alpinizmit dhe radio-amatorizmit, që kërkuan nga drejtuesit e sportit dibran projekte konkrete se si mund të kontribonin për sportin në Dibër. Më pas është kaluar në pikën me kryesore, atë të mbëeshtetejes së biznesit. Të gjithe ata që e morën fjalën, u treguan të gatshëm që të japin donacione për sportin. Mënyra se si do të bëhen këto pagesa, forma e dhënies apo shuma e përcaktuar ishin tema diskutimi. Pas shumë debatesh, është vendosur që të krijohet një bord, brenda të cilit do të jenë drejtues të bashkisë, klubit, shoqatës dhe biznesit. Konkretisht, u përcaktua që 9 të jetë numri i anëtarëve të bordit dhe u zgjodhën anëtarët e tij: Ilir Krosi, kryetar i bashkisë; Telman Perleka, drejtor i klubit Korabi; Agron Damzi, drejtues i shoqatës "Forca Korabi"; si dhe biznesmenët, Rakip Suli, Zabit Muda, Astrit Kukeli, Faik Bruçi, Fehmi Mziu dhe Musa Selami. Një mbështetje në këtë organizim dha edhe SNV, organizata hollandeze për zhvillim, që vepron prej vitesh në Shqipëri dhe në qytetin e Peshkopisë. Tashmë pritet që bordi drejtues të realizojë takimin e parë dhe të përcaktojë konkretisht se si do të realizohet mbëeshtetja e sportit dibran, që jo pa qëllim, është quajtur "Miqtë e Korabit"!

D. Methasani

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi. Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çeshtje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët.
Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.
Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.
Email: lid_gazeta@yahoo.com

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Rakip Suli, Kryetar. Hajri Mandri, Shaqir Skarra, Halil Rama, Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Mina Hysa, Hasan Leka.
ADRESA E GAZETËS:
Blloku i banesave "Gintash", Laprakë.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.
Email: lid_gazeta@yahoo.com

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka dhe numrin e saj të llogarisë në **PROCREDIT BANK**
Në lek 13-661344-0001
Euro 13-661344-0102
USD 13-661344-0203

NJOFTIM

Njoftohen anëtarët e kryesisë së Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", se mbledhja e radhës do të zhvillohet më datë 10 korrik, ora 18.00, pranë redaksisë së gazetës, Blloku "Gintash", Laprakë, me rend dite: ngritja e departamenteve të shoqatës.

NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresa tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: **(04) 357 179,** ose të na shkruani në **Email: lid_gazeta@yahoo.com**

Reklamoni biznesin tuaj!
Gazeta "Rruga e Arbërit" vë në dispozicion hapsirat e nevojshme për reklamën tuaj!
Tel.**068 31 19 232.**
Tel: **(04) 357 179.**
Email:
lid_gazeta@yahoo.com

PUSHTETARË DHE OPOZITARË?

EDHE SA KOHË DO TË VAZHDONI TË MOS E MBANI PREMTIMIN E RRUGËS SË RE TË DIBRËS "RRUGËS SË ARBRIT

Në vazhdim të shkrimit "Nuk ka pengesa për financimin e Rrugës së Arbrit"

Nga **Prof. Dr. BASHKIM LLESHI**

Në Gazetën Shqiptare të datës 25 korrik 2004, jepet njoftimi se Këshilli Kombëtar i Rrugëve, miratoi Studimin e Fizibilitetit të kryer nga Studioja e projektimit të rrugëve INFRATRANSPROJEKT në vitin 2003 për Rrugën e Rrbërit, duke miratuar variantin e dytë të studimit, i cili ka kushte teknike dhe ekonomike më të leverdishme.

Kryeministri i atëhershëm, Fatos Nano, i cili ka qenë edhe Kryetar i Këshillit Kombëtar të Rrugëve, është shprehur se "Rruga Tiranë – Dibër e quajtur ndryshe "Rruga e Arbrit" do të kthehet midis shqiptarëve". Me gjithë premtimet e bëra edhe nga ish - Ministri i Transportit, Spartak Poçi, se ndërtimi i rrugës do të fillonte në vitin 2004, premtimet ngelen në letra. Në vitin 2005, vit i zgjedhjeve parlamentare, vijuan premtimet e mëparshme si nga ish qeveritarët, ashtu edhe nga ish opozitarët që sot janë në pushtet. Do të fillonte ndërtimi i Rrugës së re të Dibrës, pra "Rrugës së Arbërit". Në çdo takim me elektoratin e Dibrës dhe Bulqizës, premtimi kryesor ishte fillimi i punës për ndërtimin e kësaj rruge. Madje, ish pushtetarët socialistë, 4 ditë para zgjedhjeve të 3 korrikut 2005, prenë shiritin e fillimit të hapjes së kësaj rruge në dalje të qytetit të Bulqizës, në vendin e quajtur Gurët e Skënderbeut, duke u tallur dhe mashtruar komunitetin dibran dhe shqiptarët brenda e jashtë vendit, sepse jo vetëm se punimet brenda pak ditësh sa mbaruan zgjedhjet u ndërprenë, por edhe aksi i rrugës, sipas studimit të fizibilitetit kalon në anën tjetër të luginës, poshtë qytetit të ri të Bulqizës në drejtim të shkollës së vjetër fillore të Vajkalit e Dragunit.

Shoqata "Bashkësia Dibrane" në Tiranë, shoqata "Nisma Dibrane"në Peshkopi dhe Shoqata "Votra Dibrane" e Dibrës së Madhe e kanë mbështetur dhe ndjekur hap pas hapi në vazhdimësi punën për studimin dhe projektimin e "Rrugës së Arbërit".

Kështu, mbështetur në një njoftim të Drejtorisë së Përgjithshme të rrugëve të muajit Maj 2005 për Tenderin që do organizohej për Projektin e Rrugës së Arbërit, Shoqata "Bashkësia Dibrane" në Tiranë i drejtohet kësaj drejtorie me datë 07.06.2005 me një kërkesë zyrtare me nr.prot,7/1 e protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve me nr.2968 dt.08.0602005, që për ta shpejtuar kryerjen e këtij projekti, meqënëse sipas tyre shteti paska planifikuar fonde për këtë punë, tenderi i kësaj rruge ti jepet Studios së Projektimit të Rrugëve që ka kryer Studimin e Fizibilitetit. Pra, ish pushtetarët e inaguruan fillimin e punës pa përfunduar projektet e zbatimit të kësaj rruge, aq më tepër pa u caktuar Studjoja që do të bente këto projekte.

Theksojmë, se në rast se kjo rrugë do të jepet me Koncensin për tu ndërtuar, nuk ka nevojë të harxhohen fonde për projektin e zbatimit, sepse kompania koncensionare i kryen vetë këto projekte. Theksojmë gjithashtu se fondet e dhëna për merametime e rikonstruksione janë fonde që nuk i shërbejnë Rrugës së Re të Dibrës, por rrugës ekzistuese, e cila është katandisur në gjendje të mjerueshme. Me shpresë se pas zgjedhjeve të 3 korrikut, ish opozitarët që u bënë pushtetarë, do ta mbajnë premtimin e dhënë dhe do të hapnin dritën jeshile për ta dhënë qysh në vitin 2005 me Koncesionin ndërtimin e kësaj rruge, me 26 Tetor 2005 i dërgova një informacion të shkurtër në në formë kërkese dhe një kopje të përmbledhjes

Zotit LULZIM BASHA, Ministër i Transportit
TIRANË

I nderuar Zoti Ministër

Në radhë të parë ju urojmë shëndet dhe suksese në detyrën e re shumë të rëndësishme.

Po ju drejtohemi Juve, ashtu si kolegëve tuaj të mëparshëm, jo vetëm si Ministër i Transportit, por edhe si anëtar i komunitetit dibran, për rrugën e Dibrës. Mbështetur në kërkesat e komunitetit dibran, Shoqatave të Dibrës në Peshkopi, Dibër të Madhe dhe Tiranë, të disa studjuesve e intelektualëve dibrane etj., në vitin 2003 është kryer Studimi i fizibilitetit të rrugës së Dibrës, nga studio Infratransproject, me drejtues Dr.Farruk Kabën.

Në nëntor të vitit 2003, ky studim u miratua në Këshillin Teknik të Drejtorisë të Pëëgjithshne të Rrugëve dhe në korrik të vitit 2004 në Këshillin Kombëtar të Rrugëve, ku u miratua varianti i dytë, i cili kalon sipas aksit të rrugës së vjetër të Arbërit: Tiranë - Shupal - Murrizë - Guri i Bardhë - Ura e Vashës - Plani i Bardhë - Bulqizë - Ura e Cerenecit - Gjoricë (kufi).


Me gjithë premtimet e ish-qeveritarëve socialistë se do të fillonte puna për hapjen e kësaj rruge, nuk u hap drita jeshile për sigurimin e fondeve ose dhënien e saj me koncension. Në maj të këtij viti, nga ish qeveritarët në pushtet u planifikua të bëhej tenderi për kryerjen e projektit të zbatimit të kësaj rruge, bile në fund të muajit qershor, 4 ditë para zgjedhjeve të 3 korrikut, ish - kryeministri preu shiritin e fillimit të kësaj rruge në një sektor afër Bulqizës, duke u tallur dhe mashtruar me komunitetin dibran dhe shqiptarët brenda e jashtë vëndit, sepse jo vetëm se punimet pas një muaj u ndërprenë, por edhe aksi i rrugës, sipas studimit të fizibilitetit, kalon në anën tjetër të luginës.

Mbështetur në rëndësinë që ka hapja e kësaj rruge, kontributi juaj, në rast se do të mbështesni propozimin për dhënien me koncension, do të jetë shumë i madh për zhvillimin ekonomik të kësaj zone, duke ju nderuar juve jo vetëm si intelektual i shquar dhe Ministër, por edhe si anëtar i komunitetit dibranë.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë një kopje të përmbledhjes së studimit të Fizibilitetit të përgatitur nga INFRATRANSPROJECT, bashkëautor i të cilës kam qënë edhe unë.

Shpresojmë në vlerësimin nga ana juaj të këtij propozimi.


Me respekt
Tiranë, 26 Tetor 2005 **Prof. Dr. BASHKIM LLESHI**


Zotit Lulzim BASHA
Minister i Transportit
Tirane

I nderuar Zoti Minister
Ne radhe te pare ju urojme shendet dhe suksese ne detyren tuaj te re shume te rendesishme.
Po ju drejtohemi juve, ashtu si kolegeve tuaj te meparshem, jo vetem si Minister i Transportit por edhe si anetar i komunitetit dibran, per rrugen e Dibres.
Mbeshtetur ne kerkesat e komunitetit dibran, Shoqatave te Dibres ne Peshkopi, Diber te Madhe dhe Tirane, te disa studjuesve e intelektualeve dibrane etj. ne vitin 2003 eshte kryer Studimi i fizibilitetit te rruges se Dibres, nga Studio Infratransproject me drejtues Dr. Farruk Kaben.
Ne nentor te vitit 2003 ky studim u miratua ne Keshillin Teknik te Drejtorise te Pergjithshme te Rrugeve dhe ne korrik te vitit 2004 ne Keshillin Kombetar te Rrugeve, ku u miratua varianti i dyte i cili kalon sipas aksit te rruges se vjeter te Arberit: Tirane-Shupal-Murrize-Guri i Bardhe-Ura e Vashes-Plani i Bardhe-Bulqize-Ura e Cerenecit-Gjoricee(kufi).
Me gjithe premtimet e ish qeveritareve socialiste se do te fillonte puna per hapjen e kesaj rruge, nuk u hap drita jeshile per sigurimin e fondeve ose dhenjen e saj me koncension.
Ne maj te ketij viti, nga ish qeveritaret ne pushtet u planifikua te behej tenderi per kryerjen e projektit te zbatimit te kesaj rruge, bile ne fund te muajit qershor, 4 dite para zgjedhjeve te korrikut ish kryeministri preu shiritin e fillimit te kesaj rruge ne nje sektor afer Bulqizes, duke u tallur dhe mashtruar me komunitetin dibran dhe shqiptaret brenda e jashte vendit, sepse jo vetem se punimet pas nje muaj u nderprene por edhe se aksi i rruges sipas studimit te fizibilitetit kalon ne anen tjeter te lugines.
Mbeshtetur ne rendesine qe ka hapja e kesaj rruge, kontributi juaj, ne rast se do te mbeshtesni propozimin per dhenjen me koncension, do te jete shume i madh per zhvillimin ekonomik te kesaj zone, duke ju nderuar juve jo vetem si intelektual i shquar dhe Minister, por edhe si anetar i komunitetit dibran.
Bashkengjitur po ju dergojme nje kopje te permbledhjes se Studimit te Fizibilitetit te pergatitur nga Infratransproject, bashkeautor i se ciles kam qene edhe une.
Shpresojme ne vleresimin nga ana Juaj te ketij propozimi.

Tirane 26 Tetor 2005

Me respekt
Prof. Dr. Bashkim LLESHI



së Studimit të Fizibilitetit të kryer në vitin 2003 e miratuar në vitin 2004, Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Z. Lulzim Basha, një kopje të së cilës e disponon edhe redaksia e Gazetës "Rruga e Arbrit".

Edhe pas këtij njoftimi, megjithëse kemi dëgjuar në emisione të ndryshme për investimet e reja që do të bëhen në infrastrukturë në shkallë vendi, për Rrugën e Re të Dibrës nuk kemi dëgjuar asnjë fjalë, bile për çudi, në një intervistë në emisioni Fix Fare të televizionit Top Channel, ku jepen kronologjikisht në kohë fushat zgjedhore dhe premtimet e bëra për hapjen e kësaj rruge, kur u pyet Ministri Basha se çdo të bëhet me Rrugën e Arbrit, ai u përgjigj *se për këtë rrugë nuk ka studim, por do të marrim masa që brenda këtij viti*, (është fjala për vitin 2006) *të bëjmë studimin dhe më pas do të mendojmë se çdo të bëjmë me tej*. Nuk e di se për çfarë studimi e ka fjalën ministri, kur Studimi i plotë i Fizibilitetit i kryer me plan shteti në vitin 2003 dhe i miratuar edhe në këshillin Kombëtar të Rrugëve në vitin 2004, ndodhet i depozituar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve në pritje për të hapur dritën jeshile, për t'u dhënë me Koncension ose për të siguruar fonde nga Donatorë të ndryshëm apo nga Shteti për të filluar punimet.

Me gjithë premtimet e bëra, viti 2005 u mbyll pa e filluar punën për hapjen e Rrugës së Re të Dibrës. Për vitin 2006 pas 4 muajsh qetësia e theu akullin Prefekti i Dibrës, zoti Xhaferr Seiti, i cili, pasi ishte njohur pothuajse me të gjitha përpjekjet e bëra, sidomos vitet e fundit nga Shoqata, individë, kuadro e specialistë, intelektualë, studiues, deputetë e deri Studio Projektimi si ajo që kreu Studimin e Fizibilitetit, me kompetencë profesionale dhe në mbështetje të detyrës që kryen, ka përgatitur një informacion për instancat më larta të shtetit, i cili në muajin maj u botua në disa organe të shtypit tonë si në gazetat "Shqip", "Rruga e Arbërit", "Dibra". Prefekti i Dibrës, Zoti Seiti, me të drejtë, zhvillimin e Prefekturës së Dibrës (rretheve të Peshkopisë, Bulqizës e Burrelit) e lidh me hapjen e kësaj rruge, e cila integron në Europë jo vetëm Dibrën. Ndërtimin e kësaj rruge, ai e quan si një nga problemet më shqetësuese, në radhë të parë të kësaj prefekture, por edhe më tej, sepse kjo rrugë nuk i shërben vetëm komunitetit Dibran brenda e jashtë vendit, po ka interesa mbarëkombëtare, sepse është një nga rrugët më të shkurtëra të korridorit Lindje-Perëndim. Pavarësisht se dy ditë më vonë në gazetën "Shqip" u shkruajt një artikull "Për ca të vërteta" që nuk i paska ditur Prefekti, sepse duke mos i ditur këto të vërteta, dikush po përvetësoka idenë e aksit të kësaj rruge, mendoj se nuk duhet të shqetësohet askush për këtë, se e vërteta më e madhe është se në idenë e aksit të kësaj rruge e ka dhënë vetë populli i Dibrës, të parët tanë, që e kanë vënë në zbatim këtë rrugë qysh në kohët më të lashta me karvane, si rruga më e shkurtër për të lidhur Dibrën me Tiranën e Durrësin, pra edhe me detin, me perëndimin. Brezit tonë nuk i ngelet gjë tjetër vetëm se këtë ide të zbuluar nga populli në kohën kur nuk ishin mjetet që kemi sot, ta ndërtojmë për ta vënë në shërbim të ekonomisë së tregut e zhvillimit të mëtejshëm të saj.

Fushata e zgjedhjeve të 3 korrikut të vitit 2005, ka qenë e katërta fushatë zgjedhore parlamentare e vendore, ku elektoratit Dibran si premtim kryesor i është bërë ndërtimi i "Rrugës së Arbërit". Po të ishin mbajtur premtimet e dhëna, kjo rrugë do të kishte mbaruar dhe do të shkonim nga Tirana në Dibër në një rrugë 100 km më të shkurtër, apo do të shkonim nga Tirana në Shkup në një rrugë mbi 100 km më të shkurtër dhe këto shkurtime janë kursim kohe, kursim shpenzimesh, parash etj. etj.

Shpresojmë që të mos vazhdohet më të mashtrohet më tej komuniteti Dibran e më gjerë dhe para fushatës së zgjedhjeve vendore që do të zhvillohen nga fundi i këtij viti të hapet drita jeshile e të fillojë ndërtimi i kësaj rruge, e kërkuar dhe e ëndërruar brez pas brezi nga populli i Dibrës.

Tiranë, Qershor 2006

Turizmi malor, sa larg jemi

Nga **ISMAIL HYSA**



Natyra na ka falur ne dibranëve një mrekulli të rrallë, që dhe shumë vende të botës do ta kishin zili. Lura me shtatë liqenet e saj, me klimën e veçantë në stinën e verës, me ujin e ftohtë dhe të pastër si kristal, me pyjet që lartojnë drejt qiellit. Ah pyjet! Sopata po bën kërdinë edhe mbi fidanat e rinj që duhen vite e vite të rriten. Ministri i Turizmit para pak ditësh u ngjit në Lurë. E kishte për herë të parë dhe domosdo që u mahnit nga ajo bukuri mahnitëse që pa. E mes burrave të Lurës premtoi se rrugën e Lurës do t'ia shtroi qeverisë që të ndërtohet sa më parë. Nuk ishte ky një premtim elektoral, se fushatat janë ende larg. Ishte një premtim që bëri drejt për drejt në popull mes atyre njerëzve të urtë, bujarë e të mençur. Është një distancë e shkurtër nga Rrëshen në Lurë, është vetëm 55 km.

Ndoshta, vërtet ministri e ka patur seriozisht atëherë nuk ka asnjë lloj pengese që Lura, kjo perlë e rrallë e natyrës shqiptare, të kthehet në një park turistik. E kanë vizituar Lurën që herët shqiptar dhe të huaj, e kanë vizituar dhe kanë mbetur të habitur me këtë mrekulli që nuk e kanë gjetur në asnjë vend tjetër. Lurën e kanë vizituar edhe pa rrugë, edhe pse nuk është shpallur park kombëtar. Po nëqoftëse ndërtohet rruga, atëherë turistët do të vërshojnë drejt Lurës.

Ministri i Turizmit vetëm se u premtoi lurasve dhe në një kohë që ai është nga Vlora. Po deputetët që kanë marrë votat në Lurë, çfarë kanë bërë deri tani. Asgjë, as nuk kanë denjuar që të thonë qoftë dhe një fjalë të vetme në parlamentin shqiptar. Pas premtimit në Lurë të Ministrit të Turizmit zotit Bujar Leskaj, menjëherë u ngrit deputeti i Elbasanit që shtroi idenë që Funarin, një fshat malor në Elbasan, të kthehet në fshat turistik.Deputetët e Dibrës pas prononcimit të Ministrit të Turizmit duhej të ishin prononcuar, por ato kanë pranuar më mirë heshtjen përballë premtimit të asaj zonë që ia kanë thënë sa e sa herë.Turizmin malor e preferon e gjithë bota, duke mbjellë hapsira të gjelbëra dhe atje ku nuk ka. Ne na e ka falur natyra dhe ja për 55 kilometra rrugë. Ndoshta nuk do të jetë e largët dita kur Lura, me ato mrekulli të rralla që mbart, do të kthehet në një qendër turistike për gjithë Ballkanin.

TË HUAJT PËR LURËN

Nga **AHMET PËRLEKA***

Lura është vizituar nga shumë personalitete të huaja të disiplinave të ndryshme. Sipas dokumentëve vizitori i parë mendohet se është Vinçenc Zimajeviç, i cili në një libër të botuar në janar të vitit 1703 shkruan: "Lura është e vendosur gati në një rafshirë midis maleve të ngarkuara me dëborë, pjesën më të madhe të vitit" [1)]. Zimajeviç, që në këtë libër ka marrë përsipër të njoftojë gjendjen kishtare në Dibër e më gjerë, vazhdon: "Lura ka një kishë kushtuar Virgjirës Nënë të ngjitur në qiell, në gjendje të mirë materiale, me një altar të vogël në gjendje të mirë që ka brenda një ikonë të bukur të zonjës (Madonës), pa pasuri të patundshme, famulli dhe qendër të Shejtë me vlerë ka vetëm pianet pa stoli dhe menepal, blerë nga famulltari prej turqve që ia kishin rrëmbyer asaj kishe, kur vranë aty brenda Dom Gjon Lurasin ndërsa po mëshonte[1)].

Në këtë të dhënë të Zimajeviçit, të tërheq vëmendjen mbiemri i famulltarit Dom Gjon Lurasi që nuk e kemi hasur as në "Defterin emror të vilajetit të Dibrës të vitit 1467", dhe as në vitet pasardhëse, veç të dhënës që na jep Zimajeviçi.

Sipas imzot Vinçenc Zimajeviçit, arqipeshkvi i Tiranës dhe apostolik në Shqipëri, në vitin 1703 - 1704, Lura kishte 61 shtëpi me 478 banorë[1)].

Pas 160 vjetësh Lurën e viziton albanologu i shquar gjerman Johan Georg Fan Han (1811 - 1868).

Në librin "Udhëtimet nëpër viset e Drinit e të Vardarit" botuar në vitin 1865, në kapitullin për Lurën, ka shkruar:

"Lura është famullia më lindore arqipeshkvisë së Durrësit... banorët e Lurës dhe të Oroshit ishin në grindje të vazhdueshme lidhur me kufijtë e tyre... Duke filluar që nga kohët e lashta kufijtë e Lurës shkojnë tek një manastir i Kamalduleseve i konsakruar me emrin e Shën Gjinit... Para këtij manastiri ka qëndruar dhe sot e kësaj dite një pemë e madhe, e cila përfaqësonte diku kufirin e krahinës së Oroshit dhe asaj të Lurës..." [2)].

Hani këtu na jep një fakt shumë interesant në lidhje me flamurin e Lurës, kur shkruan se "... çdo vit me rastin e festës së Shën Gjinit, kjo pemë zbukurohej me flamurin e Lurës dhe, famulltari i Lurës vinte këtu për të celebruar meshën solemne..." [2)]. Po kështu, domethënës është dhe zhvillimi i një panairi pranë këtij manastiri që sipas J. Hann ka vazhduar deri në vitin 1830 [2)].

Albanologu i shquar nuk ka lënë pas dore dhe zhvillimet demografike në Lurë, ku sipas tij "Dikur Lura ishte katolike dhe sipas një regjistri famullie të vitit 1737 numëronte 124 shtëpi me 1001 shpirt..."

Kjo e llogaritur në vitin 1703, kur V. Zimajeviç vizitoi Lurën ka një zhvillim demografik mbi 50 % brenda gjysëm shekulli. Kjo mund të spjegohet në dy variante. Varianti i parë mund të pohohet si një zbërthim të familjeve bërthamë. Ndërsa varianti tjetër mund të ketë të bëjë me ardhjen e fiseve të tjera nga fiset veriperëndimore.

J. Hann ka hetuar se në vitin 1757 filluan konvertimet nga katolik, në islam. Dhe në këtë kohë numëroheshin 23 shtëpi katolike krahas 90 muhamedanë. [2)]

"Lura është bajraku kryesor i grupit të tmerrshëm të Dibrës "Tigrat e Dibrës" - ka shkruar Edith Durham. Edith Durham e bëri rrugën për në Lurë në drejtimin Prizren, Lumë, Reç, Lurë. Edhe "Mbretëresha" e pa kurorëzuar e Shqipërisë. Edith Durham, na jep të dhëna shumë interesante për Lurën. "Lura përbëhet nga 200 shtëpi (me një mesatare prej dhjetë vetash për çdo shtëpi) [3)] ka shkruar ajo në librin "Brenga e Ballkanit".

E. Durham e vizitoi Lurën, në nëntor të vitit 1908. Të dhënat që jep ajo janë të gjithanshme për këtë mikrokrahinë.



Nga dyqind shtëpi që ka Lura, "vetëm njëzet janë gjithsej të krishterë, e ndër to zor të gjesh një tërsisht të krishterë, sepse disa janë kryesisht mysliman, vetëm me disa pjestarë të krishterë" [3)].

Me fjalë të tjera, tërthorazi, E. Durham ka hetuar dhe na jep bashkëjetesën në mes besimeve fetare brenda një familje. Një femonem ky, që nuk njihet në asnjë vend të rruzullit tokësor, veçse Lurës. "Në Lurë sundon kanuni i Lekës... [4)] shkruan Edit Durham.

Edith Durham kishte hetuar se Lura nuk i paguante asnjë farë takse Turqisë, "përveçse kur i nevojitej si aleate kundër kaurve në përgjithësi dhe skllavëve në veçanti. Përsa i përket bukurive natyrale të Lurës, Durham ka shkruar se ishte "Vendi më i bukur që njoh në të gjithë Shqipërinë" [4)].

Në vitin 1913 studiuesi Karl Steinmentz publikoi punimet e tij në librin "Nga Adriatiku në Drinin e Zi". Një kapitull të veçantë me mjaft interes i kushton Lurës dhe banorëve të saj. "Kraharori im, - ka shkruar Steinmentz, - punonte me forcë të madhe, në pak orë isha në Lurë, askundi nuk pashë të na prisnin me urrejtje, as këtu në brendësi të Shqipërisë së pakalueshme dhe të copëtuar nga gjakmarrjet, por nga ana tjetër do ta quaj këtë krahinë Perlë të Shqipërisë" [5)].

Duke shkruar për raportet ndërmjet konfeksioneve fetare, Steinmentz thekson se nga "300 familje Lurjane, vetëm 22 janë katolike. Pra gjatë kësaj kohe (1863 - 1913 A/P) muhamedanët, me ardhje banorësh, janë shtuar trefish, kurse katolikët kanë shkuar në rënie [5)].

Steinmentz ka hetuar dhe bashkëjetesën në një familje të dy besimeve: katolike muhamedanë. "Gjenden edhe familje, - ka shkruar Steinmentz, - ku një pjesë është katolike, ndërsa pjesa tjetër thirret islame. Nga familjet katolike 8 banojnë në Lurën e Epërme, 6 në Krej, 5 në Vunaj, 2 në Vlashaj dhe një në Pregj [5)]. Kushtet ekonomike i kanë detyruar banorët e Lurës t'i shkatërrojnë familjet e mëdha patriarkale duke krijuar familje neuklare (bërthamë). Këtë fakt e ka hetuar dhe Steinmentz: "Pas shkatërrimit të trungjeve familjare veriore edhe në Lurë, nga pasardhësit e trashëgimtarëve të familjeve të vjetra, lindi aristokracia në mjediset e shtresave më të ulta të popullit. Çdo pjesë ka përfaqësuesit e vet trashëgimtar.

Përfaqësuesi i shtresës më të lartë është i pari (kryetari) i krejtë trungut familjar që përfaqëson fisin në mbledhjen më të gjërë të kuvendit (fshatit apo të gjithë mikrokrahinës së Lurës [5)].

Steinmentz tërthorazi flet dhe për kararet e Lurës: "Për shkak të punëve të ngutshme të bujqësisë banorët e Lurës kanë rënë dakord mbi një farë bese" [5)] dhe kështu besimtarët katolikë u jepej mundësia, për të shkuar në kishë.

Edhe Steinmentz kishte marrë pjesë në një meshë në kishën e Lurës së Epërme dhe na jep një fakt shumë interesant të kënduarit në kishë të këngëve shqip: "këngët shqiptare kishtare këndoheshin nga pleqtë të drejtuar nga prifti, por nuk vërehej ndonjë pasion në të kënduar [5)].

Në korrik të vitit 1916 austriakët kryen masakra çnjerëzore në Lurë. Vetëm në degën e qershisë te kisha e Lurës u vranë 108 njerëz, krejtësisht të pafajshëm por me gjithë atë personalitetet e larta ushtarake e civile kanë qëenë të detyruara të japin konsiderata e tyre maksimale.

"Pikpamja e zyrës më me influencë ishte që kjo krahinë (Lura A/P) të trajtohej si vend i okupuar, i cili mund të qeverisej vetëm brenda ideve të aneksimit dhe se masat e gjëra të popullit duhet të konsideroheshin si kundërshtarët tonë të pa bindur, prandaj duhet të trajtohen po në këtë mënyrë me ashpërsi dhe brutalitet të veçantë..." [6)].

"U likujduan shumë persona (10 - 28 korrik 1916 në Lurë A/P) që ishin kundërshtarët tonë dhe siç duket ishin gati të ngriheshin kundër nesh...

Në këtë krahinë të njohur, veçanërisht liridashëse,... shumë sensibël për agjitacion, u evitua një kryengritje e hapur" [6)].

**** Marrë nga libri "Lura -nga lashtësia në ditët tona", Tiranë, 2003)***

1. Vençence Zimajeviç, vepër e cituar, f. 203
2. J.G Han, vepër e cituar, f. 174
3. Edith Durham, Rruga e Ballkanit, Tiranë, 1990, f. 203
4. Edith Durham, vepër e cituar, f. 205
5. Karl Steinmentz, vepër ecitur
6 . IHRSH, AV, dosja 114/5, viti 1916, nr. 2054. raport i dt 14, shtator 1916.

TË NJOHIM BIZNESMENËT E DIBRËS


Të mburremi për veprat që lëmë, jo për ata që na kanë lënë

Liman Hoxha, dibrani që rihapi "Internatin" e Kastriotit në Tiranë

Nga **SHAQIR SKARRA**

82 vjet më parë, etja e dibranëve për tu arsimuar u kurorëzua me hapjen e Internatit të Kastriotit, ku nga bangat e saj dolën shumë personalitete të shquara të kombit shqiptar, ndërkohë para katër vjetësh një tjetër dibran arsimadashës dhe patriot i quajtur Liman Hoxha, do të përsëriste të njëjtën histori, por tashmë jo në fshatin Kastriot, ku u hap Internati, por pikërisht në kryeqytetin shqiptar ku ka shumë dibranë. Madje ky 40-vjeçar nga fshati Blliçe, jo shumë larg fshatit Kastriot ku u ndërtua Internati, është i pari biznesmen i nga trevat tona që hapi një shkollë të tillë në Tiranë.

Shkolla "Sarina 2002" me administrator Liman Hoxhën, është një shkollë me të gjitha parametrat modern. Këtu mësojnë 400 nxënës, ndërsa stafi përbëhet nga 44 punonjës. Mësimdhënia fillon nga kopështi deri tek gjimnazi, pa dhe me ushqim e transport. Është vlerësuar si një nga shkollat më të mira në Shqipëri. Për shkollën janë shpenzuar deri tani 500 mijë euro. Vlen të përmenden fusha e minifutbollit, laboratori i kimisë dhe i fizikës si dhe salla e informatikës, ku çdo nxënës ka kompjuterin e tij. E veçanta është se ka nxënës që nuk paguajnë lekë për arësye të ndryshme, ndërkohë janë stimuluar edhe nxënësit me rezultate të shkëlqyera dhe fituesit e olimpiadave. Ndër ta mund të përmendim nxënësin e klasës së tetë Taulant Prençin, i cili fitoi Çmimin e Parë të Olimpiadës së Matematikës për klasat e teta për Qarkun e Tiranës, si dhe Fatjon Veliu që zuri vendin e tretë. Në të ardhmen do të stimulohen edhe nxënës të tjerë. Megjithë këto shpenzime dhe rezualtate të larta ai dëshiron që në të ardhmen, shkollën e tij ta binjakëzojë me institucione arsimore jashtë vendit, duke akorduar edhe bursa për studentët e talentuar, si dhe ta kthejë nga gjimnaz në shkollë profesionale, e pas pak vitesh të hap edhe Univerisitetin.



Internati i Kastriotit. 1925.



Pamje nga shkolla "Sarina 2002". 2006.



JETA:
Liman Hoxha ka lindur në fshatin Blliçe, në një familje me dije dhe kulturë, nga e cila ka përfituar shumë dhe Limani.. Në vitin 1989 mbaron Shkollën e Mesme "Myslim Shyri" në Fushë-Çidhën. Në vitin 1989-1990 mbaron kursin e Ushqimit në Tiranë. Më 1990-1993 punon në Gardën e Republikës së Shqipërisë. Pas kësaj kohe është marrë me tregëti duke qenë mjaft i suksesshëm. Në vitin 1999 emigron në Angli për tu rikthyer në vitin vitin 2001 për të hapur shkollën Jopublike "Sarina 2002". Është i martuar dhe ka dy vajza dhe një djalë, Sarën, Rominën dhe Samelin.Janë pra bashkimi i germave të fëmijve të tij që është emërtuar shkolla"Sarina" një emër tashmë që ka krijuar identitetin e saj.

Dibranët zënë pjesën më të madhe të shkollës "Sarina 2002", por kushti kryesor është testimi

Është për tu përmendur se 40 përqind e punonjësve të kësaj shkolle janë nga Dibra. Madje edhe drejtori i shkollës Besim Toçi është nga Peshkopia. I pyetur për këtë përzgjedhje të stafit, Limani shprehet: "Që kur hapa këtë shkollë, kisha si qëllim të ndihmoja më shumë fëmijët e dibranëve që jetojnë në kryeqytet, duke përdorur tarifa më të ulëta për ta. Në disa raste kam pranuar nxënës nga Dibra, të cilët nuk kanë pasur mundësi financiare. Gjithashtu, jam munduar të punësoj sa më shumë dibranë me një përvojë të gjatë pune në arsim dhe që kanë qenë ndër më të njohurit në prefekturën e Dibrës. Kështu, drejtori Besim Toçi, ka punuar për shumë vite drejtor në gjimnazin "Said Najdeni" në Peshkopi, ndërsa Azem Teta, për shumë vite ka qenë drejtuesi i të gjitha aktiviteteve kulturore dhe artistike të rrethit të Bulqizës, pa përmendur këtu punjonjësit e tjerë. Vitin që vjen, numri i punjonjësve nga Dibra do të jetë më i madh, pasi është një ndër prioritetet e punës sime, megjithatë kushti kryesor do të mbetet testimi. Në shkollën "Sarina" të gjithë arsimtarët vijnë me testim" -e mbyll bisedën ai

I ri, por plot ëndrra për jetën....

Të gjithë ata që e njohin dhe që e kanë njohur Liman Hoxhën flasin me plot respekt për të. Por ajo që ajo që zotëron tërë qenien e tij është guximi dhe iniciativa e çmendur për të ndërmarrë iniciativa të mëdha, që për shumë njerëz dukeshin ëndrra të parealizuara. Ideja për të hapur një shkollë JoPublike, një inciativë, sa humane, aq edhe arsimdashëse, i ka lindur që pas triumfit të demokracisë, por përshkak të mungesës së parave nuk ka mundur ta realizojë më përpara një vepër të tillë. Pas rikthimit nga Anglia kishte shumë dëshira për tu marrë me biznes, por më në fund vendosi të plotësojë dëshirën e vëllait të tij të madh, Ramazanit, për të hapur një shkollë dhe për tu shërbyer fëmijëve në nevojë. Në vitin 1989, Limani dhe Ramazani, erdhën në Tiranë familjarisht dhe kishin shumë ëndrra për jetën. Pas triumfit të demokracisë u hapën dyert edhe për ata dhe në planet që thurnin mbrëmjeve të gjata të kryeqytetit shqiptar, ishte edhe hapja e një vepre bamirësie, të dobishme për ta dhe për njerëzit në nevojë. Por, ndërkohë që Limani dhe fëmijët e Ramazanit, Emirjani, Eltoni, Besa dhe Maksi e realizuan këtë ëndërr, Ramazani nuk mundi, pasi në mbrëmjen e zezë të 12 tetor 2001, ndërroi jetë pas një aksidenti në Laprakë në një moshë shumë të re.

"Kush ndërton një shkollë, ka ndërtue një xhami"

Ndërtimi i një vepre të tillë nuk erdhi rastësisht. Kur Limani erdhi në Tiranë së bashku me katër vëllezërit e tij, filloi të merrej me tregti shumice, e cila i krijoj edhe mundësitë e para për të investuar më tej për të ardhmen.Ramazani u thoshte shpesh Limanit dhe Halitit: Na ka lënë një amanet baba, kush ndërton një shkollë, ka ndërtue një xhami.Ne jemi një familje që e kemi dashur arsimin.Kjo zonë ka nevojë për një shkollë.Pse të mos investojmë në arsim. Kaq u desh dhe Liman Hoxha një mëngjez u drejtua për në Ministrinë e Arsimit, ku titullari e priti me dashamirësi dhe i premtoi gjithë mbështetjen e dikasterit. Me paratë e fituara ai mund të hapte një biznes tjetër, nga ku mund të fitonte dhe më shumë, por amaneti i babës së tij, imam Vexhi Hoxhës, do të bëhej realitet vetëm 3 vjet pas vdekjes. Vexhi Hoxha ishte ndër nxënësit e parë të Internatit të Kastriotit, madje ka qëndruar me një bangë me aktoren e madhe dibrane, Besa Imami. Imam Vexhiu nuk u nda nga librat deri në momentet e fundit të jetës së tij. Sot në shtëpinë e Limanit është një bibliotekë e pasur me librat që ka lexuar në vite Vexhi Hoxha. Kjo edukatë dhe dije që kishte përfituar në Internat, bëri që ndjenjën për arsim dhe kulturë ta kultivonte dhe tek djemtë, të cilët të gjithë u diplomuan. Limani në fillim e nisi me një kopësht, pastaj hapi shkollën jo publike "Sarina 2002" me një emër tepër njerëzor, duke bashkuar germat e fëmijve të tij dhe tashmë ka hapur dhe shkollën e mesme të përgjithshme, të profilizuar. E ardhmja do të flasë krejt ndryshe. Limani tashmë ka ambicje në fushën e arsimit. Megjithse investimi në arsim është një biznes human, Limani është i bindur se duke investuar bindshëm në arsim, bëhet më i dobishëm për Dibrën dhe dibranët.


"Do të hap dhe një Universitet. Ky duhej të ishte ndërtuar në Dibër, por tani dhe unë djalë dibre jam dhe do ta hap në metropolin shqiptar. Kjo do të bëhet realitet shumë shpejt." Dhe Liman Hoxha si njeri me vullnet dhe kurajo nuk ka dështuar asnjëherë.

Të mburremi me atë që bëjmë ne, jo me ato që bënë të parët tanë

Liman Hoxha është krenar për veprat e mëdha të dibranëve. Duke qenë se është shumë i pasionuar pas historisë së Shqipërisë dhe veçanërisht pas historisë së popullit të Dibrës, ai ndjehet tepër i lumtur për ata që kanë lënë paraardhësit e tij, por ai dëshiron që brezat e nesërm të krenohen me veprat që do të lëmë ne sot. Ndaj, mesazhi i tij është, që çdo dibran, kudo që ndodhet ta ngrejë më lart emrin e Dibrës dhe të dibranëve përmes veprave me vlerë që në thelb të kenë bujarinë dhe humanizmin, dijen dhe shkencën. Mjaft dibranë kanë bërë emër edhe jashtë trojeve tona. Ne kemi vlera. T'i ruajmë pra ato, të mos i humbasim.Vetëm kështu mund ta nderojmë Dibrën, -përfundon ai.

Botohen për herë të parë shënimet e ***Ismail Strazimirit***

Pushtimi i Dibrës prej ushtrisë Serbe



Si nji frut t'atij shërbimi që dëshirova, por që nuk munda me i ba Atdheut e Kombit aq sa desha, po e la këtë vepër, ku kam me provue se dibranët në kundërshtim me sa flasin e mendojnë disa njerëz me gjykim të cekët- i kanë shërbye çështjes shqiptare prej kohësh tue bashkëpunue me ato që vunë themelet e indipedencës sonë. Dihet se gati gjashtëdhjet e sa vjet ma parë, Fuqitë e mëdha sambas vendimeve të traktatit të Berlinit patën pjestue tokën shqiptare ndër shtetet e Ballkanit. Natë kohë në Dibër, piksëpari u banë bisedimet paraprake dhe u morën vendimet themelore të Lidhjes së Prizrenit, t'atij Kongresi të famshëm që i bëri Fuqitë e mëdha të mendohen dhe i shtërngoi me i ndrue vendimet e dhanuna ma parë për coptimin e Shqipërisë. Vetë Abdyl Frashëri i pat shkrue Iljaz Pashë Dibrës tue i thanë se vendimet e marruna në Dibër u pritën me gëzim e kënaqsi të madhe prej parisë së jugut, porse Mustafa Pashë Vlona, delegatët e Prevezës, të Gjirokastrës dhe të viseve të tjera deklarojshin se nuk mund të shkojshin në Stamboll, po të mos shkonte dhe Iljaz Pasha. Prandaj kërkonte që dhe ai të nisej dhe t'u njoftohet telegrafisht delegatët në fjalë se ka me shkue në Stamboll. Edhe Sabri Rushiti prej Ohrit dhe Riza Bej Cermuzi prej Matit patën ba shërbime të mëdha n'atë Kongres si me fuqinë e pendës, ashtu dhe me atë të mendjes. Prapë Dibra, mbas lakmive pushtuese të shfaquna prej shteteve të Ballkanit zu një vend nderi në historinë kombëtare tue mbledhë në gji të vet delegatët e kongresit që u hap, më 22 Korrik 1910 ku u përfaqësua gjithë Shqipnia, tue përfshi brenda edhe vilajetin e Selanikut dhe ku u muerrën vendime me rëndësi mbi të drejtat kombëtare si të mësuemit e gjuhës shqipe ndër shkolla e të tjera. Kur plasi kryengritja në Kosovë, më 22 qershor 1912 shumë intelektualë dibranë u tërhoqën nëpër male dhe disa muej me radhë bënë që të valvitej madhështor flamuri i kryengritjes. Aso kohe, në mes tonë ndodheshin t'arratisurit ushtria turke dhe kapitanët shqiptarë Ismail Haki Libohova, Ismail Haki Peqini, Ismail Haki Korca dhe Ibrahim Jakova. Bashkë me ne qenë: Sadulla Strazimiri, Hafuz Sherif Langu, Shyqri Beju, nipi i Iljaz Pashës, Eqrem Cami, Dan Cami, Shahin Cami, Dervish Latifi, shehi i teqes Shaban Deda, Qamil Daci, Nurce Xhuglini, Rifat Mizoja e të tjerë nga qyteti i Dibrës së madhe, Dine Beu dhe i vëllai i Izet Bej Maqellarës, Nazif Grezhdani, Abdulla Begu, Dalip Pajku, Sefedin Ilnica e të tjerë nga krahina e Maqellarës. Kur ishim ngujue ke Livadhi i Zogut në krahinën Gollobordë, na rrethuen tre batalione t'ardhun nga Mati, Manastiri, e Dibra e Madhe. U ndoqëm rreptësisht dhe kaluem përmes shumë rreziqeve. Ma vonë kur u bashkue me ne edhe Elez Jusufi, nga katundi Dardhë e Dibrës u përhap kryengritja në të tanë Dibrën dhe e pushtuen qytetin e Dibrës së madhe. Ndërkohë, me nënshkrim të Jakup Camit prej katundit Sofracan e të Selman Kurtit prej katundit të Bucevës iu telegrafue Hasan Prishtinës në Shkup dh u pyet mënyra e veprimit. Në përgjigjen që morëm këshilloheshim me u shpërnda, mbasi gjithë kërkesat kombëtare ishin pranue me dekret mbretnor. E deri sa u muerr kjo përgjigje, nuk u shue flaka e kryengritjes. Përvec nja dy a tre bejlerëve të Tiranës e Mustafa Asimit nga Kruja, si në Gegëni ashtu edhe në Toskëni, asnjeri s'mori pjesë, sikundër duhej në këto kryengritje. Përvec kësaj edhe mospajtimi i parësisë së Kosovës ndër mendime u ba shkak që të mos parashtrohet pika ma me rëndësi e kërkesave që ishte caktimi i kufijve politikë të shqipnisë. Meqënëse mbas pak kohe plasi Lufta Ballkanike, horizonti i Shqipnisë u mbulue me re të zeza e të frikshme. Le ta gjykojnë të tjerët se deri në c'shkallë ka pasë efekt shërbimi i Dibranëve në cështjen kombëtare.

Mënyra e pushtimit

Në luftën Ballkanike që u hap në mes të Turqisë e të shteteve aleate të ballkanit, mbasi u pushtua Shkupi, Manastiri, Tetova, Gostivari, Perlepja, Kërcova, Ohri e Struga q'ishin kufitarë me Dibrën dhe mbasi disa qytetarë e katundarë Dibranë luftuen nga dhet ditë në grykën e (Radikës) me komitet e udhëheqësit Serbe, gjithashtu mbasi Elez Jusufi nga Dardha e Dibrës, me një fuqi që mundi me mbledhë, luftoj burrnisht e trimërisht në qafë të (Kolesjanit) të Lumës kunder Serbëve, të cilëve u dha shumë të vdekun, si edhe mbasi prej as ndonjë ane nuk priteshe asnjë dobi shprese, me 27 Nanduer 1912 populli iDibrës u shtrëngua t'i dorezoheej ushtrisë së rregullueshme të Serbisë me që s'kishte mbete me tjetër rrugë shpëtimi dhe me kondite që të mos ce nohej nderi, pasunija dhe jeta e njeriut. Po në këtë ditë të kobeshme Dibra zgjodh dhe coj nëVlonë si përfaqësuesin e vet Z. Myfti Vehbine për të marrë pjesë në kongresin historik që do të shpallte indipendencën.

Mënyra e administrimit të qeverisë Serbe

Qeverisja Serbe, herë mbas here , i bahej barrë popullit me taksa të randa dhe i binte në qafë tue i shkaktue ngjarje t'ashtuquejtuna politike. Drejtimi politik i administratës Serbe me këtë mënyrë në vëndin tonë aprovohesh prej katër a pesë kreneve të Dibrës, të cilët ishin stërvitë me i sigurue interesat e tyre në dam t'interesave të përgjitheshme. Këta njerëz për fat të keq, kishin arrit ta sakrifikoj edhe shtetnit e vet për interesa përsonale. Vec kësaj, gjith jetën e kishin kalue tue ba mizorina e krime të ndryshme dhe, mbasi s'kishin kurajo civile, me qëllim që ta shpëtojnë nga bajonetat Serbe, i bindeshin çdo urdhni që jepte qeverija Serbe edhe sikur t'ishte ai në dam e në mjerim të gjithë populli**.** Si konsekuencë e kësaj administrate të keqe mund të rrëfehet lëvizja fatale e malësisë së Dibrës së Madhe, e cila përfundoi me mjerimin e plotë të banorëve. Një patrullë Serbe shkoi në katundin Mazhicë dhe, pa asnjë shkak ose arsye ligjore grabiti bagetinë e Osman Çokut. Ai natyrisht kundërshton dhe banorët i vijnë në ndihmë. Mbrenda pak kohe gjithë krahina alarmohet dhe i vënë pushkën ushtrisë Serbe. Në këtë mënyrë ngjarja muerr ngjyrën e një kryengritjeje serioze. Qeverija Serbe menjëherë coi fuqina të mëdha ushtarake kundër tyre dhe mbasi u banë lufta të rrepta e të përgjakshme në mes t'ushtrisë e t'popullit, u dogj gati krejt krahina, u vranë me qindra njerëz, u grabit pasunija dhe bagëtija, gjith'ashtu u cënue nderi dhe u shue jeta e atyne rrezikzive, që s'munden me ikë. Kuptohet vetvetiu se deri në këtë ditë populli i Dibrës kaloi një jetë, për sy e faqe, të qetë, por të mërzitshme nga shkaku i robnisë së mënishme.

Si u afruen Dibranët me Esat Pashë Toptanin

Me që qeverija dhe populli i Shkodrës, sa plasi lufta Ballkanike, kërkojshin ndihmë, Jusuf Bej Hysën Agollin nga Dibra e Vogël dhe Elez Isufi nga Dardha të cilët mblodhën nga tremijë Dibranë dhe u nisën për Shkodër. Në një kohë kur bataljoni i Elez Jusufit, n'udhëtim e sipër, ndodhej në Mat, ushtrisë Serbe nga ana e Prizrenit po marshojshin drejt Lumës, punë të cilën e muarr vesht ElezJusufi. Elez Aga u muerr me vehte gjysmën e kësaj fuqije dhe u nis për nat'anë. Meqënëse se Ali Bej Zajmi, rastësisht, pat ndodhë n'at batalion, e komandoj fuqin e mbetun prej Elez Jusufit, vetvetiu u hap shtegu për me u afrue ke Esat Pasha. Esat Pasha tue dijtë farë mirë se sa do t'i vlejshin Dibranët n'arritjen e qëllimit të vet, i përkrahu dhe i nderoj përmbi të gjithë sa kohë që ndejtën në Shkodër. Me këtë mënyrë i tërhoq kah vehtja Dibranët. Këtu nuk due të rrëfej shërbimet që i ba Esat Pasha në Shkodër, as edhe nuk due të flas për vrasjen Tragjike të Hasan Pashës, i cili duket me siguri se u ba viktimë e ambicje së Esatit që donte me e marrë fuqinë. por dua çfaq dyshimin mbi një çeshtje: Si u dorëzue Shkodra, A me të vërtetë qe shtërngue nga mungesa e mjetëve luftarake, e ushqimëve dhe e ndimave, apo u ba viktima e ambicjes përsonale t'Esatit, mbasi Shkodra me gjithë sulme e pareshtuna të Malaziasve sikur flitej n'atë ditë, kishte uahqim e fuqi për me qëndrue edhe katër –pesë ditë, me qënë se edhe demostratat detare të fuqive të mëdha ishin në favor të saj. Përgjigjen e kësaj pytje ja lë t'a apin kompetentet. Ne këtë kaptinë, ma fortë se cdo gja tjetër, due te shpjegoj se si disa Dibranë, u gabuen e u banë vegla të Esatit dhe, me këtë mënyrë, dua të vecoj nga Dibranët e tjerë për me mos randue faji mbi të gjithë. Mbasi e dorëzoi Esat Pasha Shkodrën, ai duel me të gjithë ushtrinë e vet prej andej i përcjellun prej princit të Malit të Zi dhe i nderuem deri në Lezhë prej ushtrisë Malazeze. Malsorët e Dibrës, të cilët përbajshin një pjesë t'ushtrisë së esatit, u habitën nga kjo përcjellje e nga ky nderim i madh q'iu ba Esatit. Ato besuen se Esat Pasha me të vërtetë ishte njeri i mencëm, ushtar i mbaruem dhe besnik i atdheut. Kur erdhi Esat Pasha në Tiranë, i nderoi edhe ma tepër dibranët të cilët i grishte në gostina dhe ma në fund i siguroi se do tua lironte Dibrën e pushtueme prej serbëve.

(Vijon)

Duke filluar nga ky numër, gazeta "Rruga e Arbërit" do të botojë të plotë shënimet e Ismail Strazimirit, me lejen e Drita Agollit (Strazimirit) dhe Zeqi Agollit.

Poezi nga Ylli Prapa

A THUA...?

Përse pa fund i intriguer?
Nuk gjej askund asnjë shpjegim.
A pi,të dehem jam dënuar
Të djeg të zitë e fatit tim.

A thua vlera unë nuk pata?
A thua unë, të dua s'di?
Njerëzisht dorën kur ta zgjata
Buzëz së etur s'i ra në sy?

Sa ëndrra thurëm e sa shpresa
'Ca dhe nuk dalin,- ti më the
Sa herë netëve,s'gjetëm shtresa!
Sa herë yjet patën strehë!


Ku shkuan fluturimet,ciltërsia
Kur dergjej hëna kokë lart?
Në qiell mbreteronte madheshtia
Për njëri-tjetrin ishin zot.

Jetojmë prej kohësh të dyzuar
'Ne duhemi-më thua,-pse s'më merr|
Kjo botë e ligë na ka dënuar
Shpirti në parajsë-trupi në ferr.

Tiranë.3.6.2006.

Vepër specifike origjinale, me rëndësi historike kombëtare

Nga Akademik
BEDRI DEDJA



Profesor Dr. Nuri Abdiu është një nga studiuesit më të shquar shqiptarë në fushën e psikologjisë. Gjatë karierës së tij shumëvjecare si pedagog i psikologjisë (që nga viti 1958) në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, më vonë të Tiranës dhe në Universitetin e Tetovës, - ai i kushtoi një vëmëndje të posaçme studimeve si dhe teksteve të psikologjisë, sidomos të shkollave të larta në të cilat ka qënë bashkautor në dekadat e fundit. Veç artikujve të shumtë shkencorë që ka botuar herë pas here, Nuri Abdiu ka meritën se është hartuesi i parë i Bibliografisë së punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë. Vepra kryesore e tij, e cila më në fund, po vjen në duart e lexuesve përmes këtij libri, është studimi voluminoz "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (gjer më 1939)" Kjo vepër është rezultat u hulumtimeve, meditimeve, përgjithsimeve dhe botimeve monografike me përmasa më të vogla gjatë një periudhe gati njëzetvjecare. Botimet e Nuri Abdiut për këtë problem në revista e përmbledhje shkencore janë shumë, duke nisur që nga "Një vështrim historik mbi punimet shqiptare në fushën e psikologjisë (gjerë më 1939) të botuar më 1969 e gjer te punimet interesante shkencore të vitit 1989 "Mbi periodizmin e mendimit psikologjik shqiptar. Periudha e humanizmit" si dhe "Pamje nga ndihmesa e dijetarëve tanë në fushën e psikologjisë së përgjithshme", etj. Për të gjitha këto arsye, ky libër është përfundim logjik i pasionit shkencor të autorit, si hulumtues këmbëngulës, të përqëndruar seriozisht në një temë me rëndësi historike kombëtare. Vlerat e veprës spikasin në disa drejtime themelore:

Së pari, në meritën e tij se me përgjegjësi shkencore dhe qytetare ka nxjerrë në pah me sens prej pasionanti gjithë trashëgiminë kombëtare në fushën e psikologjisë, duke punuar në mënyrë intensive për të zbuluar, grumbulluar dhe analizuar një material shumë të pasur faktik dhe nga shumë autorë.

Së dyti, sistemimi dhe përgjithsimi i materialit është mjaft i arritur, po të marrim parasysh se tema është shumë e gjërë dhe e shtrirë, si në kohë, ashtu dhe në problematikë; nga kjo pikpamje studimi ka qenë shumë i mundimshëm, megjithatë autori ka treguar aftësitë e veta shkencore, jo vetëm për të gjetur boshtet e duhura, por edhe për ta kompaktësuar lëndën rreth këtyre boshteve.

Së treti, për herë të parë jepen në studim periodizmi i etapave themelore të mendimit psikologjik shqiptar që nga fillimet e tij në formën e mendësive empirike e gjer te dijet e kultivuara psikologjike të mirëfillta shkencore, të cilat nga autorë të ndryshëm shqiptarë nuk kanë kanë qenë një pasqyrim i thjeshtë i arritjeve të shkencës psikologjike botërore (të cilat nuk mund të mohohen), por edhe një përpunim origjinal në prizmin e tyre botkuptimor në përputhje me interesat e zhvillimit të shkencës shqiptare, të edukatës e të shkollës në Shqipëri, si dhe me nevojat imediate që shtronte koha për ruajtjen dhe zhvillimin e statusit historik të psikologjisë kombëtare të popullit tonë, të zhvillimit të virtyteteve më të mira të saj, të luftës kundër anëve negative që kishin kultivuar pushtuesit e huaj në psikologjinë etnike për të realizuar përçarjen e popullit, për të dobësuar bashkimin e tij në luftën për liri e pavarsi, për ruajtjen e gjuhës amtare, të dokeve dhe të zakoneve tradicionale.

Mendimi ynë është se kjo vepër e Prof. Dr. Nuri Abdiut na paraqitet si një vepër specifike origjinale, që pasuron literaturën tonë historike dhe shoqërore; vlerat e saj nuk kanë të bëjnë vetëm me zhvillimet arsimore të vendit tonë, me njohjen e tyre, me hopet që ka bërë shkolla shqipe nga një etapë në tjetrën, po edhe me evolucionin e përgjithshëm të mendimit shkencor shqiptar, në përgjithsi dhe të mendimit politik, social e filozofik, në veçanti.

Ky libër me vlerat e lartpërmendura na bind përfundimisht se Nuri Abdiu ka krijuar të gjitha premisat që në universitetet shqiptare, të trevave të ballkanit, historia e psikologjisë kombëtare të futet tanimë si një disiplinë e veçantë në degët e fakulteteve përkatëse.

(Ky shkrim është botuar në vitin 2000)

Katharsisi i odave dhe kuvendeve të Dibrës

Nga Dukagjin HATA

Kanuni, kryedokumneti i së drejtës dhe arkitipi më i qëndrueshëm psikosocial, vecanërisht në kushtet e parashtetit, në këto vite tranzicioni ka vepruar duke bjerrur shumë cilësi, që, në fakt, e kanë mbajtur atë të shenjtëruar në kohët dhe hapësirat shqiptare, ku ai ka vepruar.

Në këto kohë problematike më shumë se si rregullator i jetës së hakmarrja e gjakmarrja, Kanuni është shfaqur si një kërcënim në jetën e banorëve, si një makth i shoqëruar me pasoja të rënda ngujimesh, me rrënim ekononomik e moral të të ngujuarve dhe, mbi të gjitha si devijim nga tradita, të pakëta e të paelementëve të botës së krimit, që edhe pse kohëve të fundit po shtrëngohen në darët e strukturave të policimit, ende vazhojnë të ushqejnë kronikat e zeza me histori dhune e krimi.

Përkundrejt këtij realiteti të trishtë ku duken shenjimet e Kanunit dhe devijimet e tij, kryesisht në zonat e Veriut të vendit, Dibra vazhdon të tregojë shpirtin e saj të kulturës së mbijtesës sociale, tolerancën dhe vlerat e tjera komunitare, në kushtet e lirisë absurde. Në Dibër rastet e gjakmarrjes për shkak të hasmërive të vjetra dhe gjakmarrjet e reja kanë qenë tepër të pakëta e të papërfillshme. Aq më të pakëta kanë qenë dhe devijimet e Kanunit, me tërë kompleksin e dhunimeve që cekëm më sipër.

Kultura e dibranëve, shpirti i tyre fisnik, fryma e faljes dhe pajtimit janë apelativë të një shpirti historik, që në shekuj ka prodhuar tolerancë e bashkëjetesë, veti këto të njerëzve progresivë.

Odat dibrane kanë qenë dhe mbeten parlamente të së drejtës, vende të shenjta ku merren vendime në përputhje me interesin e komunitetit, ku sheshohen konfliktet, shtrohen rrugët e dialogut për zgjidhjen e problemeve dhe mbylljen e plagëve të së kaluarës. Fryma e kolegjialitetit dhe mencuria e dibranëve ka bërë që pas dialogjeve në këto oda të vijnë tubimet e tjera si itifaqet, etj ku ka shkëlqyer dhe vazhdon të shkëlqejë vyrtiti i pajtimit dhe bashkëjetesës së vlerave dibrane. Mjafton të përmbdim Itifakun e Shumbatit, një akt kolektiv i shumbatasve të mencur, që i është bërë barrierë gjakmarrjeve e hakmarrjeve primitive, duke mbajtur të bashkuar rreth boshtit të vlerave njerëzit dhe idetë e tyre për përmirësimin e jetës sociale të fshatit etj.

Shkaku i kësaj tabloje tjetër sociale në Dibër në raport me trevat simotra të saj, duhet kërkuar në dy aspekte thelbësore:

E para, Kanuni i Dibrës është një kanun tepër i emancipuar, ku kufizmi dhe ndalimi i gjakmarrjes është një akt human që e përshkon tejendanë këtë akt të së drejtës. Thirrja" Mos vra", në cfarëdo rrethane, sado traumatike të të jetë paraqitur ajo, është një apelativ kufizues, frenues e ndalues i cdo shfaqje vrasje, gjakmarrje e hakmarrje. Ky Kanun ngre në tempullin e hyjnive gratë dhe fëmijët, që janë të paprekshëm, madje dhe viktimat e gjakmarrjes që janë të shoqëruar me gra e fëmijë kanë një status ekstra, njësoj si trupat diplomatike në kushtet e luftës. Aktet e hakmarrjes frenetike, ku janë përfshirë dhe gratë e fëmijët, në shumë treva ku aplikohet një kanun i devijuar dhe traumatik, janë të panjohura në Dibër.

Por nuk mjafton vetëm Kanuni i emancipuar që të shmanget veprimi i të keqes kolektive. Duhet dhe një shpirt i emancipuar, njerëz humanë e të drejtë, oda e kuvende paqëtuese, të cilat Dibra i ka më bollëk.

Këto oda e kuvende, itifaqe e tubime të tjera në Dibër janë kthyer në shkolla të paqës e pajtimit, në modele sjelljeje në komunitet, vlerat civile të së cilit, më teër se kudo, duken në kulturën e sjelljes komunitare, në raport me administrimin e së drejtës.

Dibra, me të drejtë, ka fituar statusin e një treve ku peshohen gjërat, ku mendja triumfon mbi instinktet, ku pajtimi triumfon mbi hakmarrjen, ku "matet shtatë herë e pritet një herë". Ky status vazhdon të ushqejë vlera të reja, vazhdon të nxjerrë në pah protagonistë të rinj të pajtimit të gjaqeve, vazhdon të motivojë një psikologji moderne, e cila vlerëson jetën e tjetrit, jetën e kundërshtarit, jetën e hasmit, jetën e komunitetit.

Në themel të tij ky është një akt katharsisi moral, social e human i odave dhe kuvedeve të Dibrës, i Itifaqeve të saj, një shkollë e njerëzve të thjeshtë ku përgatiten misionarët e paqës e pajtimit mbarëkombëtar.

Presidenti Bush i shkruan nxënëses dibrane

Në një sallë mbështur plot me nxënës dhe prindër nga Kina, Greqia, Shqipëria, Rusia, Italia, Meksika e të tjera shtete të botës që studiojnë në Nju Jork të Sh.B.A, duatrokitën nxënësen shqiptareAnisa Teodori që i dorëzohet letra dhe certifikata e presidentit të Sh.B.A. G.Ë.Bush dhe zonja e tij Laura me rastin e dekorimit nga shkolla për rezultate të shkëlqyera..



Po kush është Anisa Teodori? Vajza 18 vjeçare e Halil e Zhuljeta Teodori nga Zerqani. Pas mbarimit të shkollës së lartë Halili punon për dy vite në Zerqan dhe vjen në Tiranë ku Anisa vajza e tij e madhe fillon shkollën 8 vjecare "Skënder Çaci".Familja Teodori largohet në Amerikë ku për anisën e vogël ishte një realitet krejt ndryshe të cilin as që e kishte imagjinuar ndonjëherë-Kur u nda nga shokët dhe shoqet e shkollës "Skënder Caci" do të shprehej para të gjithëve.- Edhe atje ku do të shkoj do të nderoi veten prindërit dhe Dibrën time të dashur.Dhe Anisa e mbajti premtimin. Në shkollën e mesme "Gover Cleverland" të Nju Jorkut në fillim pati vështirsitë si gjuha,përshtatja me një realitet krejt ndryshe me shkollat shqiptare por Anisa i përballoi me sukses të gjitha këto duke u bërë një ndër nxënëset shembullore në shkollë në displinë dhe mësime Përvec rezultateve të larta në mësime Anisa Teodori është edhe aktiviste në jetën kulturore në shkollë. Në festivalin e organizuar në prani të 3000 vetave Anisa së bashku me shoqet e saj shqiptare prezantuan kulturën tonë të bukur dhe në Nju Jork, ku morën pjesë të gjitha grupet e kombësive të ndryshme që përbënin shkollën.

Por për Anisën dhe familjen e saj padyshim e rëndësishme është letra e presidentit Bush dhe Laura si një nga nxënëset më të dalluara në këtë shkollë.Dhe ky është një inkurajim për Anisën që në të ardhmen të arrijë dhe më shumë .Anisa Teodori, 18 vjecarja që mbaroi maturën këtë vit krahas krenarisë së saj kombëtare si shqiptare ka edhe krenarinë që është dibrane, e sidomos nga një një zonë me tradita të hershme arsimdashëse si Zerqani.

Ilmi Dervishi

Botime të autorëve dibranë




Faleminderit qytetit tim!

Mbresa nga një turne i topit të vogël të ping-pongut, që ndërtoi urën e madhe të miqësisë në qytetin tim të Peshkopisë

Nga **DEFRIM METHASANI**

Ne fakt gjithmone jam ndjere krenare me qytetin tim dhe asnjehere nuk e kam fshehur te qenin djal i tij. Keto kohet e fundit, eshte sporti, ai qe ne ka risjelle me shume atje, per te promovuar ne ekranin ku une punoj prej dy vjetesh, "Tele - Sport", veprimtarite sportive qe jane zhvilluar, ne perkujtim te mjeshtrit te madh, Taxhedin Shehu. Por rasti me i frekset, ishte turneu mbarekombetar i ping-pongut per veteranet, qe mblodhi sportiste, trajnere e mjeshtra te topit te vogel, nga shume qytete te Shqiperise, por edhe Kosoves e Maqedonise. Ish mesuesi im, Shkelqim Hoxha, nje njeri mjaft pasionant, kishte muaj qe kultivonte brenda meje, deshiren e nje takimi te tille. Dhe vjen nje dite, qe njerez kurajoz me deshire, pasion dhe korrektese, kthejne ne realitet edhe endrra qe ndoshta dikujt mund ti dukeshin te pabesuseshme. Palestra e njohur e volejbollit, pikerisht, diten kur niste te rrokulliste topin e pare ngjarja me e madhe ne bote, futbolli, rimblodhi aty pas dekdash te tera, ata qe u afirmuan me kete sport. Aty pashe ish kampionin e Jugosllavise dhe Kosoves, Nehat Citaku, ish kampionin korcar, Thoma Stratoberdha, tiransin, Agron Fortuzi, elbasansin, Miraka, apo durrsakun, Selim Pumi. Aty pashe Xhemal Ciceline dhe Isuf Deden, kampionet e njohur kosovare, por ripashe edhe Edi Krifcen, Jonuz Tufen, Gezim Tosunin, apo Xhorxhi Skufin, emra te zgjedhur te ping-pongut shqiptar. Ne ate palester, ripashe edhe rraketen me te vjeter te turneut, 72- vjecarin Shemsi Manjani, apo sportistin e shquar, ish futbollist, volejbollist e ping-pongist, Lut Manjani. Ne ate palester, takova edhe doctor Dacin nga Dibra e Madhe, apo te nderuarin Islam Rama nga Dibra e vogel. Ishin me shume se 70 dhe e kam te veshitire te vazhdoj me emra…



Ishin dy dite qe ne kalendar i kam shkruar si te paharrueshme, sepse vertet organizimi qe model. Mikrpitja tipike dibrane, tregoi vlerat, me te cilat ne mburremi dhe per fat te mire ne gjendjen civile kemi te shenuar aty ky shkruhet vendlinja, rrethin Diber, apo qytetin Peshkopi. Ndeshjet qene mjaft emocionuese dhe ne kete shkrim, nuk do te merrem me fituesit, pasi te gjithe aty qene fitues. Mjafton t'ju kujtoj nje moment kur gjate ndeshjeve, fonia niste nje kenge tradicionale qe pasqyron nje moment historik te Dibres, pikerisht ajo e Hajredin Pasha, (tashme e rinovuar dhe perpunuar). Ka mjaftuar kjo kenge, qe gjithe pjesmarresit te futen ne valle e te harrojne perse ishin mbledhur. Kufijte tashme mes Kosoves, Shqiperise, apo viseve shqiptare te Maqedonise, duket se jane shkrire, sidomos kur eshte fjala per veprimtari te tilla sportive. Ky top sado i vogel, por i bardhe, ngriti ne piedestal vlerat e qytetit dhe njerezve tane. Miqte e ardhur e kishin te veshtire kthimin ne qytetet, apo vendet e tyre. Ata moren me vete jo vetem kupat, medaljet, apo diplomat e pjesmarrjes se tyre ne turneun mberkombetar te quajtur "Rugova", apo aromen e blireve te rralle, por edhe vlerat reale te nje qyteti, qe ka njerez civil e te kulturuar, qe pasionin e kane jo vetem personal, por e kane vene ne sherbim te qytetit te tyre dhe njerezve. Mesazhet, imeilet, apo vlersimet qe erdhen pas ketij turneu, kane qene te shumta, ndersa une e kisha te veshitire te perzgjedh, ne kronikken time te rastit, momentet me te bukura. Lotet e miqve nga Kosova, apo emocionet e tyre, akoma i kam ne sy. Ata falenderonin me zemer, duke shprehur mirnjohjen per kete organizim dhe mrekulli qe realizoi stafi organizator, me ne krye pasionantin Shkelqim Hoxha, qe u ndihmua, po nga biznesmene dibrane, te cileve u shpreh falenderime, nga bashkia e qytetit, klubi Korabi, shoqata sportive "Forca Korabi" dhe mjaft miq te tjere.

Edhe njehere, une kam te drejte te them, faleminderit qytetit tim, sepse ne fund te fundit, te gjithe jemi te atij qyteti dhe asaj treve qe prodhon miresi, qytetari, kulture, ide dhe respekt per njerezit…

Fusha e Gjuricës

Lumi Drini i Zi ndan kufirin e Maqedonisë me Shqipërinë. Kufirin Shqipëri/Maqedoni. Fusha e Gjuricës ndodhet në pjesën lindore të Shqipërisë, në afërsi të Bulqizës. Ndërsa nga qyteti i Dibrës së Madhe është 5 km në Perëndim të qytetit. Në mes të fotografisë shihet lumi Drin i Zi, i cili ndan kufirin Maqedon me atë Shqipëtar. Fotografia është nxjerrë nga ana e fshatit Solokiq në territorin Maqedon. Parashikohet që RRUGA E ARBËRIT të kalojë këtej...



KOMENTE

"Fotografi e mahnitshme!!" *(Tironsi)*
"Shuummëë e bukur.." *(Tironsi2)*
"Sikur ta kishte e gjithë Shqipëria këtë gjallni ngjyrash, që në pak vende shifet. *(Agashi)*
"Është fat për atë që është Dibran, këto pamje janë mahnitëse, sa dëshirë kisha që së shpejti t'i vizitoj këto bukuri të Shqipërisë tonë, që duhet të mburret çdo shqipëtar, kudo që është." *(Robert Nikaj, Gjakove)*
„E kam për nder që jam dibran" (Besi)
"Hajredin Pasha vjen Radikës / vallë ku janë o këto Malet e Dibrës? / Vallë ku janë o këto malet e Dibrës / mbajnë kuvend o në fush t'Gjoricës/ … *(Bes Dibrani)*
"Ah moj Dibër, nëna ime, tani jam mbush plot me gëzime *(Mërgimtari)*
"Po kam qenë vetë në këtë vend more, dhe se kam vlerësuar kaq shumë. Eh sa mu shtua malli për Shqipërinë". *(Bana Kore)*
"Wowwwwwwww. Po sa bukur bre ky vend! Qenka foto FANTASTIKE. Keni vende FANTASTIKE në Dibër!" *(Gjilan Gjikja)*
"Në këto fusha turqit e lan kokën". *(kimleci@hotmail.com)*
"Të dua Dibër se je me të vërtet e bukur ashtu sikurse je ti i dashuri im nga Dibra." *(Prishtinasja)*

Dibra ka shumë vende të bukura. Por shumë prej tyre, nuk na bëjnë përshtypje, ngaqë jemi rritur mes tyre e jemi ngopur me to. Por, këto bukuri, kur dalin në sytë e botës, fitojnë më shumë vlera. Atëherë në rikthejmë sytë e vëmendjen drejt tyre, duke kuptuar e shijuar bukuritë e vendlindjes sonë. Një e tillë, është edhe kjo foto e z. Gazmend Kërkurti, një dibrani me banim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili çdo vit bën një udhëtim në vendlindjen e tij të dashur dhe bën fotografi. S'pushon së bëri fotografi, për t'ja prezantuar pastaj botës nëpërmjet internetit. Kjo foto është njëra prej tyre. Nga interneti, gjithashtu, ju ofrojmë edhe disa komente mbi këtë foto.

REDAKSIA

Grafika: ***Studio "m&b"****. Tel: (04) 233 283. Shtypur në shtypshkronjën "****Dita 2000****". Tel: (04)* ***273 745***